


Alkmet
E. D. D. D. D.
Per Sekretarin
Keshillit



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Mr 141 Prot
Dt. 08.01.21



Nr. 104/ Prot.

Korçë, më 06.01.2021

Lënda : Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

Mbështetur në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të vendimeve nr.158, nr.161, nr.162, nr.163, nr.164, nr.165, nr.166, nr.167, nr.168, nr.169, nr.170, nr.171, nr.172, nr.175, nr.176, nr.177, datë 23.12.2020 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenet 3, 8, 9, 24, 40, 41, 51, 54, 55, të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr.24/2017 "Për administrimin e ujtitjes dhe kullimit", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", në ligjin nr.10296, datë 09.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, në vendimin nr.350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.175, datë 8.3.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar, në udhëzimet plotësuese nr.10, datë 28.02.2020 dhe nr.27, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023" dhe në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve nr.157, nr.160, nr.173, nr.174, datë 23.12.2020 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë do të shprehemi brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 16, pika 2/b të ligjit nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut".



Adresa: L. 7 Rr. "28 Nëntori", Tel: 08224 2953 , e-mail: Prefekti.Korce@mb.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR. 172 DATË 23 / 12 / 2020

**MBI MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË KOLONJË DHE
NDËRMARJEVE TË VARËSISË SI DHË NIVELIT TË PAGAVE PËR VITIN 2021.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjit nr. 68/2017, datë, 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Vendimin Nr 177 Datë 08.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr 165 Datë 02.03.2016 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 165 datë 02.03.2016 "Për Grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore ,për efekt page ,dhe përcaktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Qeverisjes vendore VKM Nr.175 datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa të punonjësve mësimorë dhe arsimit parauniversitar" i ndryshuar me VKM Nr.191 datë 05.04.2019, Vkm Nr.187 datë 08.03.2017, Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", VKM Nr.350 datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të MZSH", me propozim të kryetarit të bashkisë , Këshilli i Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës 23 / 12 /2020.

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Kolonjë për vitin 2021: **285** punonjës (dyqindetëdhjetëpesë).
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit dhe personat e tjerë të zgjedhur ose të emëruar në Bashkinë Kolonjë, në institucionet dhe ndërmarjet e varësisë sipas përcaktimeve në lidhjet e mëposhtme:

Lidhja nr.1 -

Niveli I pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë Kolonjë.

EMËRTIMI	Kategori	Grupi	Shtesa për poz.	Vjetërsi
Kryetar	-	-	86100	-
Nënkryetar	-	-	75500	-
Këshilltar	III	a/1	42800	2%
Sekretar I Përgjithshëm	I	b	55000	2%
Sekretar Këshilli	II	b	49000	2%
Drejtor Drejtorisë	II	b	49000	2%
Përgjegjës Sek	III	a/1	42800	2%
Përgjegjës Sek	III	b	35000	2%

Specialist I	IV	a	31500	2%
Specialist II	IV	b	26000	2%
Sekretar kryet.	IV	b	26750	2%
Administrator	-	-	58800	-

Lidhja Nr.2 - Niveli I pagës për punonjësit administrativë.

Nr.	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi në %
1	Sanitar, Korrier	I	30000	1%
2	Roje pa armë, punonjës shërbimi	II	31600	1%
3	Roje Kaldaist	III	32500	1%
4	Kamerier, Punonjës mirëmbajtje të profesioneve të ndryshme, shofer autoveture, shofer automjeti deri 2.5 ton	IV	33400	1%
5	Magaznier	V	34100	1%
6	Teknik Ndërtimi, Kuzhinier, Fotograf, Teknik I mesëm I specialiteteve të ndryshme, instrumentist, aktor, ciceron, regjizor, mekanik, hidraulik, marangoz, elektrikist,	VI	34500	1%
7	ska	VII	35000	1%
8	Bibliotekar, Shofer transporti me automjet mbi 2.5 ton	VIII	35400	1%
9	Arkivist, Llogaritar (ekonomist I mesëm), topograf, Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe mjeteve speciale, Sekretar në arsimin parauniversitar	IX	36000	1%
10	ska	X	36500	1%
11	Përgjegjës oficine e transporti, kryekujdestar në qendër përkujdesi social,	XI	37000	1%
12	ska	XII	37500	1%
13	Ndihmës manovrator i makinerive të rënda	XIII	38200	1%
14	Manovrator i makinerive të rënda	XIV	39000	1%
15	Punonjës të tjerë administrativë	VKM Nr.177/g	39000	1%

Lidhja Nr.3 - Niveli I pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr.	Emërtimi	Paga
1	Kryeinspektor I Policisë Bashkiake	50000
2	Inspektor I Policisë Bashkiake	44000
3	Punonjës I Policisë Bashkiake	40000

Lidhja Nr.4 - Niveli I pagave për punonjësit e MZSH-së.

Nr.	Emërtimi	Paga	Shtesa për natyrë të vecantë pune	Shtesa për Vjetërsi
1	Inspektor Zjarrfikës	56000	6000	1%
2	Kryezjarrfikës	48000	8000	1%
3	Zjarrfikës	46000	8000	1%
4	Asistent Zjarrfikës	40000	7000	1%

Lidhja 5 - Niveli I pagave për funksionet e deleguara.

QKB

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Specialist	38000	IV/b	2%

BORDI I KULLIMIT

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Përgjegjës	38000	IV/b	2%
2	Specialist	29500	IV/c	2%

QKF

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Përgjegjës	44000	VKM 191	2%
2	Instruktor	42500	VKM 191	2%
3	Edukator	34000	VKM 191	2%

GJENDJA CIVILE

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Specialiste zyre GJC	38000	IV/b	2%

PARASHKOLLOR

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Drejtor kopshti	42500	VKM 191	2%
2	Edukator arsimit I lartë	36650	VKM 191	2%
3	Edukator arsimit I mesëm	34000	VKM 191	2%

KONVIKTI

Nr.	Emërtim	Paga Poz	Kategori	Vjetërsi
1	Edukator konvikti/a.lartë	39300	VKM 191	2%
2	Kujdestar/ arsimit I mesëm	36650	VKM 191	1%

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e bashkisë Kolonjë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

LIRJAN HYSINI

